



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsu, 60000, Gjiilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Taktika Kriminalistike

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Taktika kriminalistike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Lëndë zgjedhore
Viti i studimeve:	2019/2020-viti i III-të, semestri i V-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5/ECTS
Koha / lokacioni:	Ligjërata: E hënë, ora: 10:00 deri në 11:30 Asistent: Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Feti Limani, Prof. Ass.
Detajet kontaktuese:	fetilimani@hotmail.com
Përshkrimi dhe qëllimi i studimit të lëndës:	<i>Taktika kriminalistike</i> paraqet një sistem metodash shkencore, të cilat zbatohen në procesin e përgatitjes dhe të zhvillimit të veprimtarive operative- hetimore dhe gjyqësore drejtë zbulimit, zbardhjes së më të shpejtë dhe më të plotë të veprave penale dhe kryerësve të tyre, si dhe venjen e të njejtve para drejtësisë duke ju shqiptuar të njejtëve edhe dënimet e merituar ligjore për veprat e kryera. Qëllimi kryesor i lëndës është që studentëve të Fakultetit Juridik t'u ofrohen njohuri të përgjithshme mbi zbulimin, hetimin, sqarimin drejtë parandalimit të krimit. Siq dihet studentët që përfundojnë këto studime mund të punësohen në institucione të ndryshme shtetërore të cilat ballafaqohen në mënyra të ndryshme me kriminalitetin, si p.sh. në gjykata, polici, prokurori publike, avokati, ente për ekzekutimin e sanksioneve penale etj., andaj njohuritë e fituara nga lënda e <i>Taktikës kriminalistike</i>, atyre mund t'u shërbejnë në masë të konsiderueshme në punën e tyre të përditshme për pengimin, zbulimin dhe sqarimin e kriminalitetit. Në kuadër të lëndës së <i>Taktikës kriminalistike</i>, studentëve iu ofrohen njohuritë e përgjithshme mbi <i>Taktikën kriminalistike</i> zanafillën, historikun, metodat dhe objektin e saj shkencor. Përveç këtyre njohurive të përgjithshme, pjesërisht përpunohen edhe dy pjesët e rëndësishme të Kriminalistikës dhe atë: Teknika Kriminalistike dhe Metodika Kriminalistike.

	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje: 1. Të përshkruaj dhe pjesërisht të përdorë disa mjete të Taktikës kriminalistike që përdoren në fiksimin e gjurmëve të veprave penale në përgjithësi; 2. Të përshkruaj dhe pjesërisht të përdorë metodat shkencore për identifikimin e gjurmëve etj..		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Më të përfunduar të këtij kursi (studimi), kandidati do të jetë në gjendje që më sukses të interpretojë dhe të zbatojë: 1. Format më të mira dhe më të suksesshme të veprimeve operative kriminalistike drejt hetimit dhe zbulimit të veprave penale dhe kryerësve të tyre; 2. Të zbatojë metodat sa më të përsosura të hetimit dhe zbulimit të veprave penale dhe kryesve të tyre; 3. Që të jetë në gjendje që me sukses të zbatojë ligjin dhe rregullat kriminalistike drejt zbulimit dhe ndriqimit të krimeve dhe kryesve të tyre si dhe 3. Që të kontribojë në përkufizimin dhe parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2		2
Ushtrime teorike/laboratorike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2		2
Kollokfiume,seminare	1		1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2		2
Përgatitja përfundimtare për provim	2		2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1		1
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali	10		10
Metodologjia e mësimdhënies:	1. Metoda e mësimdhënies aktive Në mbështetje të kësaj metode shpjegohen, përkufizohen nocionet mbi institutet themelore të <i>Taktikës kriminalistike</i> , si degë e sistemit juridik, interpretimi i drejtë dhe i qartë i tyre, e sidomos duke veçuar rëndësinë e jetësimit të parimeve dhe dispozitave tjera. 2. Metoda e mësimdhënies inter-aktive		

	Zhvillimi i hovshëm i shoqërisë së sotme, si dhe rritja me ritme marramendëse e informacionit, i ndihmuar nga mjetet e shumëllojshme të transmetimit e komunikimit masiv, kanë bërë të mundur që mësimdhënia dhe mësimnxënia të ndryshojë në mënyrë rapide. 3. Metoda krahasuese Ju mundëson studentëve njohjen dhe krahasimin e instituteve më të rëndësishme të taktikës kriminalistike dhe të rregullimit të kësaj fushe hetimore të vendeve fqinje dhe më gjërë. 4. Metoda e analizës Kjo metodë u mundëson studentëve të kuptuarit më fundamental të instituteve dhe parimeve me të cilat shërbehet <i>Taktika kriminalistike</i> dhe atë duke e bërë zbërthimin – analizën përmajtësore të dispozitave në të cilat përkufizohen parimet kryesore dhe institutet themelore të sferës së <i>Taktikës kriminalistike</i> me qëllim të aftësimit të studentëve, që pas përfundimit të studimeve të jenë në gjendje të bëjnë zgjidhjen e çështjeve nga fushëveprimtaria e kësaj lëmie jo vetëm në aspektin teorik por edhe në aspektin praktik në gjyqësinë e vendit. 5. Metoda e studimit të rasteve Rëndësi të veçantë gjatë interpretimit dhe shpjegimit të instituteve themelore të <i>Taktikës kriminalistike</i> ka edhe studimi i rasteve të veçanta nga praktika gjyqësore lidhur më këtë lëmi.
Metodat e vlerësimit:	Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Testi gjysmësemestral dhe ai final mbahen me shkrim. Në vlerësimin përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë. - Testi gjysmësemestral 30% - Testi final 50% - Aktiviteti në orë (seminar, ese, detyre shtëpie, etj) 15% - Pjesëmarrja 5% Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50, nuk mbërrijnë/përmbyllin notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	Dr. Feti Limani, <i>Kriminalistika</i>, Ligjërata të autorizuara. Dr. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015 si dhe Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004; Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika Kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001;

Literatura shtesë:	Kodi i Drejtësis për të Mitur i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010; Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës; Kodi i Procedurës Penale të Kosovës , 2004; Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2004; Kodi Penal i Republikës së Kosovës 2013; Ligjerata të autorizuar të mësimdhënësit; Ligji mbi rendin publik i Kosovës , 2010; Ligji mbi sigurinë e trafikut rrugor i Kosovës, 2006 dhe Ligji për Ekzektimin e Sanksioneve Penale, Prishtinë, 2004.
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Nocioni, njohuritë e përgjithshme kriminalistike 1. Zhvillimi i Kriminalistikës 2. Shkenca e kriminalistikës në luftimin e kriminalitetit 2.1. "Policia shkencore" 2.2. Krimi i organizuar 2.3. Taktika klasike e hetimit kundër krimit të organizuar 3. Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër kriminalitetit 3.1. Policia ndërkombëtare 3.1. Interpoli 3.2. Europoli Literatura: Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i> , Prishtinë, 2001. Prof. Dr. Skendër Begeja, <i>Kriminalistika</i> , Tiranë, 2001.
Java e dytë:	Planifikimi i hetimit të një çështjeje konkrete penale ne veçanti te veprat penale në sferën e trafikut publik 1. Identifikimi kriminalistik 1.1. Identifikimi kriminalistik i personit në bazë të tipareve të jashtme 2. Antropometria 3. Fotografia e përshkruar 4. Identifikimi i personit ne bazë të gjurmëve gjenetike të ADN-ës 5. Identifikimi i personit në bazë të erës Literatura: Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i> , Prishtinë, 2001. Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i> , Prishtinë, 2015.
Java e tretë:	1. Parimet themelore të Kriminalistikës për hetimin, zbulimin dhe

	luftimin e veprave penale në përgjithësi me theks te posaçëm siguria te veprat në trafikun publik (komunikacion) <i>a. Parimi i lirisë teknike-taktike</i> <i>b. Parimi metodik dhe i planifikimit të procedurës</i> <i>c. Parimi i shqyrtimit kritik të veprimit</i> <i>ç. Parimi shpejtësisë dhe befasisë</i> <i>d. Parimi i themelësisë dhe këmbëngulsisë</i> <i>dh. Parimi i objektivitetit-paanësisë</i> <i>e. Parimi i drejtimit unik të veprimeve operative-taktike për çdo çështje veç e veç</i> <i>ë. Parimi i koordinimit dhe bashkëpunimit</i> <i>f. Parimi i ekonomizimit në të vepruar</i> <i>g. Parimi i diskrecionit (konspiracionit)</i> <i>gj. Parimi i ligjshmërisë dhe</i> <i>Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër kriminalitetit-</i> Literatura: Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015. Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001.
Java e katërt:	Baza shkencore dhe sistemi i taktikës kriminalistike 1. Kuptimi dhe llojet e veprimtarive operative 2. Mënyra e informimit për përgatitjen ose ekzistimin e veprës penale <i>a. veprimtaria informative kriminalistike</i> <i>b. informatori</i> <i>c. informimi me kallëzim apo ankim</i> <i>ç. kallëzimi nga inspektorët apo revizioni</i> <i>d. kallëzimi nga i dëmtuari</i> <i>e. kallëzimi nga dëshmitari</i> <i>ë. kallëzimi anonim</i> <i>f. pseudonimi</i> <i>g. të përfolurit</i> <i>h. vetëkallëzimi apo (kryesi paraqet veprën e tij)</i> <i>i. mjetet e informimit</i> Literatura: Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001. Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004. Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004.

Java e pestë:	Metoda Indiciale e zbulimit dhe e hetimit të veprave penale 1. Kuptimi dhe ndarja e indicjeve 2. Metodatat e zbulimit të veprave penale përmes indicjeve 3. Taktika e zbulimit të motiveve të veprës penale Literatura: Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001. Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004.
Java e gjashtë:	Ngritja e versioneve hetimore (karakteristikat kriminalistike) 1. Kuptimi i versioneve hetimore 2. Klasifikimi i versioneve hetimore 3. Ngritja e versioneve hetimore 4. Verifikimi i versioneve hetimore Patrullimi, vëzhgimi, prita, racia 1. Patrullimi dhe vëzhgimi 2. Prita 3. Racia Veprimtaria e gjurmimit 1. Kuptimi i veprimtarisë së gjurmimit 2. Llojet e veprimtarisë së gjurmimit-Evidencat Literatura: Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001.
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë intermediar që do të përmbajë deri në 20 pyetje nga literature e shtjelluar gjerë me tani.
Java e tetë:	Metodat dhe teknikat e zbulimit të veprave penale në përgjithësi me theks të posaçëm të veprat penale kundër trafikut publik 1. Këqyrja e vendit të ngjarjes 1.1. Përgatitja e organit procedurës për këqyrje 2.2. Masat e ruajtjes së vendit të ngjarjes 1.3. Masat në vendin e ngjarjes 2. Këqyrja e vendit të ngjarjes 2.1. Organizimi i këqyrjes së vendit të ngjarjes 2.2. Këqyrja e plotë e vendit të ngjarjes 2.3. Këqyrja e viktrimës 2.4. Këqyrja e gjendjes teknike të automjetit 2.5. Fiksimi i rezultateve nga këqyrja e vendit të ngjarjes 3. Fotografimi i vendit të ngjarjes 3.1. Llojet e fotografimit të vendit të ngjarjes 3.1.1. Fotografimi orjentues 3.1.2. Fotografimi i pamjes së përgjithshme 3.1.3. Fotografimi i objektit kryesor

	3.1.4. Fotografimi i detajeve 3.1.5. Skica e vendit të ngjarjes Literatura: Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i>, Prishtinë 2015. Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004.
Java e nëntë:	Odorologjia kriminalistike Qentë në shërbim të zbulimit të kryerësit të veprës penale 1. Qentë e stërvitur 1.2. Llojet e qenve të stërvitur 1.3. Kushtet për shfrytëzimin e qenit gjurmues 1.4. Identifikimi i erës së njerëve me ndihmën e qenve të stërvitur Taktika e zbatimit të masës së arrestit 1. Ndjekja penale 2. Taktika e arrestit 2.1. Vendndodhja e personit i cili arrestohet 2.2. Si duhet të kryehet arresti 2.3. Kategorizimi i personave të cilët duhet të arrestohen 2.4. Vendi ku kryehet arresti Kontrollimi në banesë, në një vend të hapët dhe të personit 1. Kuptimi dhe rëndësia e kontrollimit 2. Përgatitja për kontrollim 3. Kontrollimi në banesë 4. Kontrollimi i personit 5. Llojet e veçanta të kontrollimit 6. Metodatat e fiksimit të rezultateve të kontrollimit
Java e dhjetë:	Baza psikologjike e pyetjes 1. Kuptimi dhe rëndësia e pyetjes 2. Bazat psikologjike në pyetjes 2.1. Perceptimi 2.2. Kujtesa 2.3. Riprodhimi 3. Taktika dhe metoda e pyetjes të veprat penale në sigurinë e trafikut publik 3.1. Taktika dhe metoda e pyetjes së të pandehurit të veprat penale në trafikun publik 3.2. Taktika e pyetjes së dëshmitarëve 3.3. Taktika e pyetjes së dëshmitarëve qëllim keq 3.4. Taktika e pyetjes së të dëmtuarit 3.5. Taktika e pyetjes së femijëve dhe të miturve Literatura: Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015.

Java e njëmbdhjetë:	Taktika e ballafaqimit 1. Ballafaqimi 2. Taktika e zbulimit dhe shfrytëzimit të marrëveshjeve të fshehta ndërmjet fajtorëve 3. Shkaqet e marrëveshjeve të fshehta ndërmjet fajtorëve 4. Mënyrat e marrëveshjeve të fshehta ndërmjet fajtorëve Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004. Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015.
Java e dymbëdhjetë:	Simulimi-Kuptimi dhe zbulimi i simulimit 1. Llojet e simulimit 1.1. Vilania 1.2. Epilepsia 1.3. Shurdhimi 1.4. Të kufizuarit 1.5. Sëmundjet e ndryshme shpirtërore Taktika e identifikimit me njohjen e personave, kufomave dhe sendeve 1. Kuptimi dhe rëndësia e identifikimit me njohje 2. Përgatitja për identifikim me njohje 3. Paraqitja për njohjen e personave 4. Paraqitja për njohjen e kufomave 5. Paraqitja për njohjen e sendeve (corpora delikti) 6. Njohja përmes fotografisë Fiksimi dhe vlerësimi i rezultateve të identifikimit me njohje Literatura: Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001 dhe Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015.
Java e trembëdhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar që do të përmbajë deri në 20 pyetje të shtjelluara në procesin mësimor gjatë këtij semestri.

Java e katërbëdhjetë:	Eksperimenti kriminalistik 1. Zhvillimi i eksperimentit të hetimi dhe zbulimi i veprave penale në trafik, rregullat dhe metodat e zhvillimit të eksperimentit 1.2. Eksperimenti për ta vërtetuar mundësinë e të parit 1.3. Eksperimenti për ta vërtetuar mundësinë e të dëgjuarit 1.4. Eksperimenti për ta vërtetuar mundësinë e disa veprimeve të caktuara 1.5. Eksperimenti për ta vërtetuar mundësinë e disa veprimeve brenda një kohe të caktuar Fiksimi dhe vlerësimi i rezultateve të eksperimentit Literatura: Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001 Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015.
Java e pesëmbëdhjetë:	Ekspertimi kriminalistik 1. Kuptimi 2. Llojet e ekspertimit 3. Caktimi i ekspertimit 4. Ekspertimi mjeko-ligjor, psikologjik i drejtuesit të automjetit Literatura: Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001. Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë gjatë periudhës 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015. Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2015.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
- Fillimi dhe përfundimi i orës mësimore në pajtim me orarin dhe informatën për studentët; - Mos përdorimi i telefonit mobil gjatë ligjeratës; - Mospirja e duhanit; - Moskonsumimi pijeve dhe ushqimeve të ndryshme; - Mos të kopjojnë gjatë provimit dhe testimeve të tjera; - Komunikimi civilizues dhe dinjitoz me studentë; - Sigurimi i qetësisë dhe disiplinës gjatë orës së mësimi si dhe - Të dëgjojnë me kujdes si mësimdhënësin ashtu edhe kolegët e tyre.